



Projekti i Binjakëzimit i Bashkimit Evropian "Ndihmë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit - Direktiva e BE 2006/123 /KE për Shërbime"

Ky projekt i përbashkët nga Republika e Kroacisë dhe Republika Federale e Gjermanisë synon të mbështesë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në zbatimin e Direktivës së BE-së 2006/123 /KE për Shërbime.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të mbështesë më tej integrimin e Kosovës në ekonominë botërore dhe të forcojë rolin e administratës së Kosovës në qeverisjen ekonomike përmes funksioneve efektive rregullatore në përputhje me detyrimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

Qëllimi specifik i këtij projekti është të mbështesë qeverinë e Kosovës për të zhvilluar më tej kapacitetin e saj institucional për të krijuar bazën për një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat në përputhje me acquis të Bashkimit dhe kërkesat e MSA-së.

Partnerët e Projektit do të vënë theks të veçantë në sigurimin e mekanizmave adekuat për koordinim dhe bashkëpunim me të gjitha projektet dhe aktivitetet e ndërlidhura - të përmendura në fishën e Binjakëzimit si dhe projektet dhe aktivitetet të cilat mund të zënë vend gjatë zbatimit të projektit.

Duke pasur një përafrim të plotë të legjislacionit vendor me Direktivën e Shërbimeve, mund të mënjanohej shumë lloje të pengesave administrative dhe rregullatore për lirinë e ofrimit të shërbimeve, si dhe rregulloret sektoriale do të harmonizohen me Direktivën e Shërbimeve, të cilat inkurajojnë thjeshtimin dhe dixhitalizimin e procedurave administrative dhe procesin e licencimit për aktivitetet specifike në sektorin e shërbimeve si dhe sigurimin e të gjithë informacionit në një vend.

Gjatë dy viteve të ardhshme (nëntor 2020 - tetor 2022), projekti i financuar nga BE-ja do të mbështesë Qeverinë e Kosovës për të zhvilluar më tej kapacitetet e saj institucionale, në mënyrë që të krijojë bazën për një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat në përputhje me trashëgiminë ligjore të BE-së dhe Kërkesat e MSA-së.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të mbështesë më tej integrimin e Kosovës në ekonominë botërore dhe të forcojë rolin e administratës së Kosovës në qeverisjen ekonomike përmes funksioneve efektive rregullatore në përputhje me detyrimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Projekti i binjakëzimit do të mbështesë më tej zhvillimin e ekonomisë së Kosovës duke zvogëluar barrën administrative, duke vendosur një kornizë më të qartë ligjore dhe duke siguruar qasje më të lehtë në informacion mbi rregulloret e sektorit të shërbimeve përmes Pikës së Vetme të Kontaktit.

Projekti i Binjakëzimit do të ketë ndikim pozitiv në qasjen më të lehtë të tregut për bizneset duke rritur konkurrencën e sipërmarrësve përmes dinamizmit të tregut, madje edhe duke rritur inovacionin dhe duke ju ofruar konsumatorëve më shumë mundësi dhe zgjedhje.

